

**KOMBET E
BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë prej Vitit 1991 Lënda Nr. IT-04-84bis-PT
Data: 14 janar 2011
Origjinali: anglisht

NË DHOMËN GJYQËSORE II

Para: Gjykatësit Bakone Justice Moloto, Kryegjykatës
Gjykatësit Burton Hall
Gjykatësit Guy Delvoie

Sekretari: Z. John Hocking

Vendim: 14 janar 2011

PROKURORI

kundër

**RAMUSH HARADINAJT
IDRIZ BALAJT
LAHI BRAHIMAJT**

PUBLIK

**VENDIM MBI FORMËN E SHKURTUAR TË AKTAKUZËS SË NDRYSHUAR
PËR HERË TË KATËRT**

Zyrës së Prokurorit:

Z. Paul Rogers

Avokatëve të Mbrojtjes:

Z. Ben Emmerson QC dhe Z. Rodney Dixon për Ramush Haradinajn
Z. Gregor Guy-Smith dhe Zj. Colleen Rohan për Idriz Balajn
Z. Richard Harvey dhe Z. Paul Troop për Lahi Brahimajn

KJO DHOMË GJYQËSORE e Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Të Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991 (“Tribunali”) ka marrë “Parashtrim në Emër të Ramush Haradinajt mbi Versionin e Ri të Aktakuzës për Rigjykim të Pjesshëm” dorëzuar më 23 nëntor 2010 (“Parashtrimi i Haradinajt”), “Përgjigje në Emër të Lahi Brahimaajt ndaj Mocionit të Prokurorisë për Aktakuzën”, dorëzuar më 23 nëntor 2010 dhe “Mocion i Idriz Balajt Kundër Versionit të Ri të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katër të Rishikuar”, dorëzuar më 23 nëntor 2010 (“Parashtrim i Balajt”) (së bashku “Parashtrime të Mbrojtjes”) dhe paraqet më poshtë vendimin përmbledhës përkatës.

I. HISTORIA PROCEDURALE

1. Më 21 korrik 2010 Dhoma e Apelit shfuqizoi vendimet e Dhomës Gjyqësore për dhënien e pafajësisë Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimaajt në lidhje me disa pika dhe urdhëroi rigjykim të pjesshëm.¹
2. Më 15 shtator 2010 Dhoma Gjyqësore urdhëroi që Aktakuza e Ndryshuar për Herë të Katërt të jetë aktakuza në fuqi gjatë rigjykimit të pjesshëm.²
3. Në Konferencën mbi Gjendjen mbajtur më 23 shtator 2010, Gjykatësi Paragjyqësor i urdhëroi palët që brenda 28 tetorit 2010, të paraqisnin bashkërisht aktakuzën në fuqi në formë të shkurtuar që të korrespondonte me lëndën e rigjykimit të pjesshëm.³ Në Konferencën mbi Gjendjen, më 26 tetor 2010, Gjykatësi Paragjyqësor e ndryshoi urdhrin e lëshuar më 23 shtator 2010, duke kërkuar që aktakuza e ndryshuar të paraqitej vetëm prej Prokurorisë.⁴

¹ *Prokurori k Haradinajt, Balajt dhe Brahimaajt*, Lënda Nr. IT-04-84-A, Aktgjykim, 19 korrik 2010 (“Aktgjykimi i Apelit”), para 377

² Urdhër lidhur me Aktakuzën në Fuqi dhe Vetëdeklarimet, 15 shtator 2010

³ T. 5 (23 shtator 2010).

⁴ T. 45-46 (26 tetor 2010).

4. Më 28 tetor 2010 Prokuroria dorëzoi “Parashtrim i Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt të Rishikuar”, në të cilin paraqiti një version të rishikuar të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt “në përputhje me urdhrin e Dhomës së Apelit për rigjykim të pjesshëm” Versioni i ri i Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt përmbante ndryshime të bëra nëpërmjet përdorimit të opsionit “tracking” /shënim” dhe paragrafët e pikat nuk ishin numërtuar në mënyrë të njëpasnjëshme.

5. Më 3 nëntor 2010 Gjykatësi Paragjyqësor urdhëroi që Prokuroria të dorëzojë versionet “e shënuara” dhe “të pastra” të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt që korrespondojnë me lëndën e rigjykimit të pjesshëm dhe paragrafët e pikat të jenë numërtuar në mënyrë të njëpasnjëshme (“version i ri i Aktakuzës”) dhe që Mbrojtja të paraqesë parashtrime ku të deklarohej se versioni i ri i Aktakuzës korrespondon me lëndën e rigjykimit të pjesshëm urdhëruar prej Dhomës së Apelit.⁵

6. Më 9 nëntor 2010, Prokuroria dorëzoi “Parashtrim i Versionit të Ri të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt të Rishikuar” i cili përmbante versionet “e shënuara” dhe “të pastra” të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt që korrespondojnë me lëndën e rigjykimit të pjesshëm (“Aktakuza e Shkurtuar”).⁶

7. Pas Parashtrimeve të Mbrojtjes dorëzuar më 23 nëntor 2010, Prokuroria dorëzoi më 7 dhjetor 2010, “Përgjigje Përmbledhëse e Prokurorisë ndaj Parashtrimeve të Mbrojtjes për Versionin e Ri të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt të Rishikuar” më 7 dhjetor 2010 (“Përgjigje”).

8. Më 13 dhjetor 2010 Idriz Balaj dorëzoi “Kërkesë e Idriz Balajt për Leje për Kundërpërgjigje dhe Kundërpërgjigje ndaj Përgjigjes Përmbledhëse të Prokurorisë ndaj Mocioneve të Mbrojtjes mbi Versionin e Ri të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt të Rishikuar” (“Kundërpërgjigje e Balajt”). Më 14 dhjetor 2010 Lahi Brahimaj dorëzoi konfidencialisht “Kërkesë e Lahi Brahimajt për Leje për Kundërpërgjigje dhe

⁵ Urdhër Lidhur me Aktakuzën e Ndryshuar për Herë të Katërt të Rishikuar, 3 nëntor 2010 (“Urdhër i 3 nëntorit 2010”).

⁶ Parashtrim i Versionit të Ri të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt të Rishikuar, 9 nëntor 2010 (“Parashtrim i Prokurorisë”), Shtojcat A dhe B.

Kundërpërgjigje ndaj Përgjigjes Përmbledhëse të Prokurorisë ndaj Mocioneve të Mbrojtjes mbi Versionin e Ri të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt të Rishikuar” (“Kundërpërgjigje e Brahimajt”)

II. PARASHTRIME TË PALËVE

A. Mocionet e Mbrojtjes Kundër Aktakuzës së Shkurtuar

9. Ramush Haradinaj parashtroi se Aktakuza e Shkurtuar përmban akuza të cilat janë jashtë kuadrit të rigjyimit urdhëruar prej Dhomës së Apelit dhe shtjelluar prej Prokurorisë në apel.⁷ Në këtë aspekt Haradinaj parashtroi se akuzat lidhur me Ndërmarrjen e Përbashkët Kriminale (“NPK”), pjesëmarrjen e tij në të, përshkrimi i fakteve që nuk kanë lidhje me Jabllanicën dhe incidentet konkrete që pretendohet se kanë ndodhur atje, duhen korrigjuar dhe/ose fshirë prej Aktakuzës së Shkurtuar.⁸

10. Haradinaj argumenton se Dhoma e Apelit “thjesht e ngushtoi kuadrin e rigjyimit në krimet e përmendura në Pikat 24, 26, 28, 30, 32 dhe 34 mbi bazën e pretendimit për pjesëmarrje të të akuzuarit në NPK për kryerjen e këtyre krimeve në shtabin e UÇK-së dhe në burgun e pretenduar në Jabllanicë.”⁹ Ai argumenton se kuadri i NPK-së kufizohet prej Urdhrit të Dhomës së Apelit vetëm për kryerjen e këtyre krimeve në Jabllanicë.¹⁰ Gjithashtu Haradinaj parashtroi se pretendimi se NPK-ja “përfshinte” Jabllanicën, Prokuroria lë të hapur mundësinë e paraqitjes së provave që do të ishin jashtë kuadrit të rigjyimit të urdhëruar nga Dhoma e Apelit.¹¹

11. Më tej Haradinaj argumenton se duhen përjashtuar provat të cilat nuk kanë lidhje me zonën e Jabllanicës.¹²

⁷ Parashtrim i Haradinajt, para 3, 6-8, 10.

⁸ *Po aty.*, para 3, 13, 15-17.

⁹ *Po aty.*, para 8.

¹⁰ *Po aty.*, para 8.

¹¹ *Po aty.*, para 14.

¹² *Po aty.*, para 3, 21.

12. Idriz Balaj parashtron se ndryshimi i planit apo qëllimit të përbashkët të NPK-së parashtruar në Aktakuzën e Shkurtuar shkel urdhrin e Dhomës Gjyqësore të 15 shtatorit 2010, parimin *res judicata*, dhe është ligjërisht i ndaluar.¹³ Balaj argumenton se Aktgjykimi i Apelit nuk e lejon Prokurorinë të ndryshojë pretendimin për planin apo qëllimin e përbashkët të NPK-së mbi bazën e të cilit u gjykua i Akuzuari,¹⁴ dhe se çdo ndryshim i tillë gjithashtu ndalohet prej parimit *res judicata*.¹⁵ Balaj parashtron se parimi *non bis in idem* e ndalon Prokurorinë që të akuzojë në Aktakuzë dhe/ose të paraqesë prova në gjyq në lidhje me pretendimet faktike për të cilat ai u shpall i pafajshëm në gjykimin e shkallës së parë.¹⁶ Balaj kërkon që Dhoma Gjyqësore të urdhërojë Prokurorinë që të ndryshojë Aktakuzën e Shkurtuar në mënyrë që të përmbajë të njëjtat pretendimet të gjykit të shkallës së parë në lidhje me planin ose qëllimin e përbashkët të NPK-së.¹⁷

13. Lahi Brahimaj parashtron se rigjykimi i tij për Pikat 3 dhe 5 sikundër parashihet në Aktakuzë nuk përputhet me Aktgjykimin e Apelit dhe shkel parimin *ne bis in idem*.¹⁸ Brahimaj deklaron se Pika 3 ende përfshin akuzën se ai kreu trajtim mizor dhe torturim, edhe pse Prokuroria pretendon se nuk po orvatet ta fajësojë për krimet në këtë Pikë.¹⁹ Ai parashtron se Dhoma e Apelit deklaroi konkretisht se ai nuk do të rigjykohej për Pikat 3 dhe 5 dhe rrjedhimisht Aktakuza e Shkurtuar nuk i përmbahet Aktgjykimit të Apelit.²⁰ Ai argumenton se në Pikën 5, Prokuroria po përpiqet të ndryshojë pikën origjinale në mënyrë që ai të gjykohet sërish për një pikë në lidhje me të cilën tashmë është shpallur fajtor dhe për të cilën ka kryer dënimin.²¹

14. Brahimaj parashtron se paragrafët 30(b) dhe 41 të Aktakuzës së Shkurtuar përmbajnë data materiale kundërthënëse dhe ai kërkon sqarim në lidhje me kohën që Prokuroria pretendon se në Jabllanicë kishte një objekt burgimi.²²

¹³ Parashtrim i Balajt, para 11.

¹⁴ *Po aty.*, para 15.

¹⁵ *Po aty.*, para 19-23.

¹⁶ *Po aty.*, para 29.

¹⁷ *Po aty.*, para 30.

¹⁸ Parashtrim i Brahimajt, para 2. *Shih edhe* para 14-39.

¹⁹ *Po aty.*, para 14.

²⁰ *Po aty.*, para 34.

²¹ *Po aty.*, para 38.

²² *Po aty.*, para 2c, 40-42.

15. Brahimaj parashtron se paragrafi 24 i Aktakuzës së Shkurtuar është materialisht dhe thelbësisht i ndryshëm nga paragrafi korrespondues i aktakuzës së mëparshme.²³ Ai argumenton se megjithëse Mbrojtja parashikoi se kuadri gjeografik i NPK-së do të kufizohej në zonën e Jabllanicës, nuk pritej që të paraqitej një formë thelbësisht e ndryshme e NPK-së.²⁴ Sipas Brahimajt, ky rishikim rezulton në ndryshimin e paraqitjes së NPK-së, nëpërmjet një forme tërësisht të re përgjegjësie,²⁵ duke e ballafaquar në këtë mënyrë me rrezik të shtuar të shpalljes fajtor.²⁶ Gjithashtu ai parashtron se për arsye se argumentimi i NPK-së nuk ofron hollësi elementin e nevojshëm mendor,²⁷ Aktakuza e Shkurtuar nuk ofron informacion të mjaftueshëm që ai të kuptojë natyrën dhe shkakun e akuzave kundër tij dhe për pasojë ka mangësi.²⁸ Brahimaj argumenton se për shkak se Prokuroria nuk ka kërkuar leje për ndryshimin e aktakuzës, ajo nuk ka respektuar Rregullën 50 të Rregullores së Procedurës dhe Provave (“Rregullorja”)²⁹ dhe nuk ka treguar zellin e duhur³⁰ dhe se leja për të ndryshuar do të shkaktonte vonesë të procesit.³¹

16. Brahimaj kërkon që Dhoma Gjyqësore të heqë prej Aktakuzës së Shkurtuar akuzat që nuk përputhen me Urdhrin e Dhomës së Apelit, ose ndryshe të urdhërojë Prokurorinë që të fshijë emrin e tij nga lista e të akuzuarve për Pikat 3 dhe 5, të përcaktojë nëse Prokuroria pretendon se burgu në Jabllanicë u ngrit nga prilli apo mesi i majit 1998; dhe të ndryshojë Aktakuzën e Shkurtuar për t’iu përmbajtur akuzave në lidhje me planin ose synimin e përbashkët të NPK-së sikundër u parashtrua më parë në Aktakuzën e Ndryshuar për Herë të Katërt dhe t’i mundësojë Brahimajt të njihet me shtrirjen dhe kuadrin e akuzave kundër tij.³²

B. Përgjigje

²³ *Po aty.*, para 53.

²⁴ *Po aty.*, para 53.

²⁵ *Po aty.*, para 54.

²⁶ *Po aty.*, para 55.

²⁷ *Po aty.*, para 56.

²⁸ *Po aty.*, para 57-58.

²⁹ *Po aty.*, para 59.

³⁰ *Po aty.*, para 60.

³¹ *Po aty.*, para 61-63

³² *Po aty.*, para 64.

17. Prokuroria parashtroi se duke e kufizuar NPK-në në krimet e kryera në Jabllanicë, Aktakuza e Shkurtuar përputhet me Urdhrin e Dhomës së Apelit për rigjykim.³³ Sipas Prokurorisë, argumenti i Balajt se parashtrimi *res judicata* e ndalon Prokurorinë të paraqesë paragrafin 24 në argumentimin ligjor aktual, është i paqartë.³⁴ Prokuroria argumenton se Aktakuza e Shkurtuar nuk përmban akuza të reja dhe se Prokuroria nuk ka dështuar në kërkimin e autorizimit për ndryshimin e Aktakuzës sepse ka vepruar në bazë të urdhrit të Dhomës Gjyqësore.³⁵ Sipas argumentit të saj, NPK-ja nuk është e re dhe argumenti i Brahimajt në lidhje me nevojën për demonstrimin e zellit të duhur është i pavend.³⁶

18. Prokuroria parashtroi se nuk po orvatet të rigjykojë Brahimajn për Pikën 3 ose për akuzat në Pikën 5 lidhur me krimet kundër Dëshmitarit 3, por për akuzat në Pikën 5 në lidhje me Pal Krasniqin dhe Skënder Kuqin.³⁷ Më tej Prokuroria parashtroi se apelimi kundër përdorimit të fajësisë së Brahimajt dhe provave mbështetëse për të vërtetuar fajësinë e tij, është i nxituar.³⁸ Sipas saj, përdorimi i provave në lidhje me akuzat për të cilat Brahimaj u shpall fajtor më herët, nuk përbën shkelje të parimit *non bis in idem*,³⁹ dhe se ky parim nuk shkelet prej rigjykimit të Brahimajt për akuzat në Pikën 5 në lidhje me krimet kundër Pal Krasniqit dhe Skënder Kuqit.⁴⁰ Prokuroria parashtroi se Aktgjykimi i Apelit nuk përjashton rigjykim për akuzat e Pikës 5 në lidhje me të cilat Brahimaj u shpall i pafajshëm.⁴¹

19. Prokuroria argumenton se Aktakuza e Shkurtuar nuk është e mangët sepse i shtjellon në masë të mjaftueshme faktet materiale dhe se hollësi të tjera janë dhënë në parashtrimet e Prokurorisë sipas Rregullës 65 *ter* (E)⁴² dhe se parashtrimet e Haradinajt dhe Balajt në lidhje me përjashtimin e provave dalin jashtë kuadrit të urdhrit të Dhomës

³³ Përgjigje, para 2.

³⁴ *Po aty.*, para 7.

³⁵ *Po aty.*, para 8.

³⁶ *Po aty.*, para 9.

³⁷ *Po aty.*, para 11.

³⁸ *Po aty.*, para 11.

³⁹ *Po aty.*, para 12.

⁴⁰ *Po aty.*, para 13.

⁴¹ *Po aty.*, para 14.

⁴² *Po aty.*, para 17.

Gjyqësore ndaj Mbrojtjes për të deklaruar nëse Aktakuza e Shkurtuar korrespondon me lëndën e rigjykimit të pjesshëm.⁴³

C. Kundërpërgjigjet e Mbrojtjes

1. Kundërpërgjigje e Balajt

20. Idriz Balaj kërkon leje për të paraqitur kundërpërgjigjen.⁴⁴ Ai parashtroi se verdiktet e pafajësisë për gjashtë pika u shfuqizuan sepse shumica e Dhomës së Apelit konkludoi se Dhoma Gjyqësore shpërdori kompetencën e vetë gjykuese duke mos i dhënë Prokurorisë më shumë kohë për të mundësuar paraqitjen e dy dëshmitarëve në gjyq⁴⁵ dhe se Dhoma e Apelit nuk sugjeroi se Prokuroria ishte e lirë të ndryshonte akuzat në lidhje me NPK-në në Aktakuzën e Ndryshuar për Herë të Katërt.⁴⁶

21. Në përgjigje të argumentit të Prokurorisë se NPK-ja “nuk është e re” sepse objektivi për kryerjen e krimeve në Jabllanicë ishte “gjithmonë element thelbësor në argumentimin e Prokurorisë”, Balaj parashtroi se kjo provon pikëpamjen e tij, sepse akuzat lidhur me Jabllanicën ishin dhe mbeten vetëm një ndër “elementët” bazë të akuzave të Prokurorisë në lidhje me NPK-në.⁴⁷

2. Kundërpërgjigje e Brahimajt

22. Lahi Brahimaj kërkon leje për të paraqitur kundërpërgjigjen.⁴⁸ Brahimaj parashtroi se Prokuroria nuk e ka zgjidhur si duhet problemin e pasaktësisë dhe paqartësisë së formës së NPK-së së pretenduar⁴⁹ dhe se mungesa e saktësisë rezulton në mangësi.⁵⁰ Sipas Brahimajt, Prokuroria është urdhëruar ta shkurtojë aktakuzën dhe jo ta

⁴³ Po aty., para 18.

⁴⁴ Kundërpërgjigje e Balajt, para 5, 18.

⁴⁵ Po aty., para 9.

⁴⁶ Po aty., para 10.

⁴⁷ Po aty., para 12-13.

⁴⁸ Kundërpërgjigje e Brahimajt, para 16.

⁴⁹ Po aty., para 7.

⁵⁰ Po aty., para 8.

ndryshojë⁵¹ dhe se jurisprudenca e Tribunalit dikton që Prokuroria të kërkojë leje kur propozon ndryshim material të aktakuzës.⁵²

23. Brahimaj parashtroi se shtjellimi i Pikës 3 tregon se ai mbetet i akuzuar në bazë të kësaj pike⁵³ dhe se kjo përbën shkelje të parimit *ne bis in idem*,⁵⁴ dhe se Dhoma e Apelit nuk urdhëroi rigjykimin e tij në lidhje me Pikën 5 dhe megjithatë Prokuroria po përpiqet ta gjykojë atë për këtë Pikë.⁵⁵

III. DISKUTIM

A. Konkluzionet e Dhomës së Apelit

24. Në lidhje me Pikën e Parë të Apelit, Dhoma e Apelit konkludoi si më poshtë:

50. Për këto arsye, Dhoma e Apelit, me përjashtim të mendimit mospajtues të Gjykatës Robinson, miraton këtë pikë të Apelit të Prokurorisë dhe shfuqizon vendimin e Dhomës Gjyqësore të: (a) shpalljes së pafajësisë së Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt për pjesëmarrje në një NPK për të kryer krime në shtabin e UÇK-së dhe në burgun në Jabllanicë sipas Pikave 24, 26, 28, 30, 32 dhe 34 të Aktakuzës; (b) shpalljes së pafajësisë së Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt për përgjegjësi individuale penale sipas Pikave 24 dhe 34 të Aktakuzës; dhe (c) shpalljes së pafajësisë së Lahi Brahimajt për përgjegjësi individuale penale sipas Pikës 26 të Aktakuzës. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit urdhëron rigjykimin e Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt për këto pika.

51. Mirëpo Dhoma e Apelit nuk do ta interpretojë Apelin e Prokurorisë si kërkesë për të shfuqizuar fajësinë e Lahi Brahimajt lidhur me dy nga pikat e lartpërmendura për të cilat ai u dënua, gjegjësisht Pikat 28 dhe 32. Rrjedhimisht Lahi Brahimaj nuk do të rigjykohet lidhur me këto dy pika.⁵⁶

25. Në pjesën vendimore, ndër të tjera Dhoma e Apelit konkludoi se

MIRATON Pikën 1 të Apelit, me përjashtim të mospajtimit prej Gjykatës Robinson, dhe **HEDH POSHTË** vendimin e Dhomës Gjyqësore : (a) që shpalli të pafajshëm Ramush Haradinajn dhe Idriz Balajn për pjesëmarrje në një ndërmarrje të përbashkët kriminale për kryerjen e krimeve në shtabin dhe burgun e UÇK-së në Jabllanicë në lidhje me Pikat 24, 26, 28, 30, 32, dhe 34 të Aktakuzës; (b) që shpalli të pafajshëm Lahi Brahimajn për pjesëmarrje në një ndërmarrje të përbashkët kriminale për kryerjen e krimeve në shtabin dhe burgun e UÇK-së në Jabllanicë në lidhje me Pikat 24, 26, 30, dhe

⁵¹ *Po aty.*, para 9.

⁵² *Po aty.*, para 10.

⁵³ *Po aty.*, para 11.

⁵⁴ *Po aty.*, para 12.

⁵⁵ *Po aty.*, para 14-15.

⁵⁶ Aktgjykimi i Apelit, para 50-51.

34 të Aktakuzës; (c) që shpalli të pafajshëm Ramush Haradinajn, Idriz Balajn, dhe Lahi Brahimajn për përgjegjësi individuale penale në lidhje me Pikat 24 dhe 34 të Aktakuzës; dhe (d) që shpalli të pafajshëm Lahi Brahimajn për përgjegjësi individuale penale në lidhje me Pikën 26 të Aktakuzës, dhe **URDHËRON** që Ramush Haradinaj, Idriz Balaj, dhe Lahi Brahimaj të rigjykohen në lidhje me këto pika;⁵⁷

B. Kuadri i Ndërmarrjes së Përbashkët Kriminale

26. Në paragrafin 24 të Aktakuzës së Shkurtuar, paragrafi 26 i Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt u ndryshua si më poshtë:

Qëllimi i përbashkët kriminal i NPK-së ishte ~~konsolidimi i kontrollit të plotë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës mbi Zonën Operative të Dukagjinit përmes largimit të paligjshëm dhe keqtrajtimit të civilëve serbë dhe përmes keqtrajtimit të civilëve shqiptarë kosovarë, romë/egjiptianë kosovarë dhe civilëve të tjerë, të cilët bashkëpunonin ose mendohej se kishin bashkëpunuar me forcat serbe ose se nuk e kishin përkrahur UÇK-në. Qëllimi i përbashkët kriminal përfshinte kryerjen e krimeve kundër njerëzimit sipas Nenit 5 dhe shkeljet e ligjeve ose zakoneve të luftës sipas Nenit 3 ndër të cilat vrasje, përndjekje, veprime çnjerëzore, trajtim mizor, burgime të paligjshme dhe tortura. NPK-ja përfshinte ngritjen dhe funksionimin e objekteve të burgimit të UÇK-së dhe keqtrajtimin e personave të mbajtur në këto objekte, ndër të tjera në selitë e shtabeve të UÇK-së në Jabllanicë dhe në Glogjan dhe në shtabin e Shqiponjave të Zeza në Irzniq.~~

27. Qëllimi i përbashkët kriminal i NPK-së në Aktakuzën e Ndryshuar për Herë të Katërt kishte të bënte me kontrollin e UÇK-së mbi Zonën Operative të Dukagjinit, kurse në Aktakuzën e Shkurtuar është keqtrajtimi i kategorive të ndryshme të civilëve.

28. Dhoma e Apelit konkludoi se veçanërisht mossigurimi i dhënies së dëshmisë prej Shefqet Kabashit dhe dëshmitarit tjetër rezultoi në dështim të drejtësisë dhe për këtë arsye urdhëroi rigjykim të pjesshëm.⁵⁸ Ajo gjykoi se dëshmitë e të dy dëshmitarëve mund të kishin qenë të rëndësishme lidhur me përgjegjësinë e të akuzuarve për “krimet e kryera në shtabin e UÇK-së dhe në burgun në Jabllanicë, përfshirë dhe krimet e kryera nëpërmjet të NPK-së së pretenduar”.⁵⁹ Dhoma e Apelit urdhëroi rigjykim vetëm në lidhje me pikat e Aktakuzës ku përmendeshin krime të tilla. Me fjalë të tjera, Dhoma e Apelit konkludoi se në rigjykimin e pjesshëm akuzat e pjesëmarrjes në NPK për të cilat do të rigjykoreshin të Akuzuarit, duheshin kufizuar në aktet e pjesëmarrjes në NPK që

⁵⁷ Po aty., para 377.

⁵⁸ Po aty., para 49-50.

⁵⁹ Po aty., para 38.

rezultuan në krime të kryera në shtabin e UÇK-së dhe burgun në Jabllanicë. Me nxjerrjen e këtij konkluzioni, Dhoma e Apelit nuk konkludoi automatikisht se edhe qëllimi i përbashkët i NPK-së duhej ndryshuar. Në fakt Dhoma e Apelit iu referua “pretendimit për NPK-në” pa deklaruar se kjo ishte diçka e ndryshme prej NPK-së së pretenduar në Aktakuzën e Ndryshuar për Herë të katërt e cila ishte aktakuza në fuqi në gjykimin e shkallës së parë.

29. Në Urdhrin e 3 nëntorit 2010 Dhoma Gjyqësore theksoi se Aktakuza e Ndryshuar për Herë të Katërt ishte aktakuza në fuqi⁶⁰ dhe duke marrë parasysh se ishte në interes të drejtësisë dhe zhvillimit të shpejtë të procesit që kuadri i rigjyimit të pjesshëm urdhëruar prej Dhomës së Apelit të jetë i qartë, Dhoma Gjyqësore urdhëroi që Prokuroria të dorëzojë versione të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt që korrespondojnë me lëndën e rigjyimit të pjesshëm.⁶¹ Synimi i Dhomës Gjyqësore ishte që Prokuroria të dorëzonte një version të aktakuzës në fuqi që të trajtojë lëndën e rigjyimit të pjesshëm urdhëruar prej Dhomës së Apelit dhe kështu e kuptoi edhe Prokuroria Urdhrin e 3 nëntorit 2010.⁶² Në këtë fazë nuk përjashtohet një ndryshim i aktakuzës në fuqi bazuar në Rregullën 50, mirëpo Dhoma Gjyqësore nuk e ftoi Prokurorinë të bënte ndryshim, as Prokuroria nuk pretendoi të bënte ndryshime të tilla.

30. Prokuroria parashtroi se Dhoma e Apelit e ka ngushtuar kuadrin e rigjyimit të pjesshëm në “elementin Jabllanica të NPK-së” dhe citon paragrafin 50 të Aktgjyimit të Apelit në mbështetje të pretendimit të saj.⁶³ Çdo interpretim i frazës “pjesëmarrje në një NPK për të kryer krime në shtabin e UÇK-së dhe në burgun në Jabllanicë” në paragrafët 50 dhe 377 të Aktgjyimit të Apelit se Dhoma e Apelit parashikoi një kuadër më të ngushtë të NPK-së krahasuar me çfarë u shtjellua në Aktakuzën e Ndryshuar për Herë të Katërt, është i pavend. Dhoma e Apelit ka ravijëzuar *pjesëmarrje* më të kufizuar, dhe jo NPK më të kufizuar. Rrjedhimisht NPK-ja është ajo që përkufizohet në Aktakuzën e Ndryshuar për Herë të Katërt, por krimet për të cilat do të rigjykohen të Akuzuarit, kanë lidhje vetëm me pjesëmarrjen e tyre, në rast se ka pasur, në kryerjen e krimeve në shtabin

⁶⁰ Urdhri i 3 nëntorit 2010, f. 1.

⁶¹ *Po aty*, f. 2.

⁶² Parashtrim i Prokurorisë, para 1; Përgjigje e Prokurorisë, para 4, 5.

⁶³ Përgjigje, para. 4.

dhe burgun e UÇK-së në Jabllanicë. Me fjalë të tjera fraza “pjesëmarrje në një NPK për të kryer krime në shtabin e UÇK-së dhe në burgun në Jabllanicë” lë të kuptohet se kryerja e krimeve në shtabin dhe burgun e UÇK-së në Jabllanicë ishte pjesë e qëllimit të përbashkët kriminal të NPK-së, mirëpo nuk nënkupton se qëllimi i përbashkët i NPK-së përbëhej vetëm prej veprimeve të tilla. Si në paragrafin 50 po ashtu edhe në paragrafin 377 fraza është përdorur për t’iu referuar përgjegjësisë penale për të cilën Dhoma Gjyqësore i shpalli të Akuzuarit të pafajshëm. Rrjedhimisht referimi do të ishte vetëm për NPK-në e parashtruar në Aktakuzën e Ndryshuar për Herë të Katërt. Urdhri i Dhomës së Apelit për rigjykim të pjesshëm ka të bëjë vetëm *me pjesëmarrjen e të Akuzuarve* në NPK, dhe jo vetë me NPK-në. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore konkludon se Dhoma e Apelit nuk urdhëroi ndryshime në qëllimin e përbashkët ose në krimet brenda kuadrit të këtij qëllimi.

C. Akuzat në Aktakuzën e Shkurtuar

31. Në paragrafin 50 të Aktgjykimit të Apelit, Dhoma e Apelit me përjashtim të mospajtimit të Gjykatësit Robinson ndër të tjera “[shfuqizoi] [vendimin] e Dhomës Gjyqësore të [...] shpalljes së pafajësisë së Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimaajt për pjesëmarrje në një NPK për të kryer krime në shtabin e UÇK-së dhe në burgun në Jabllanicë sipas Pikave 24, 26, 28, 30, 32 dhe 34 të Aktakuzës dhe urdhëroi rigjykimin e tyre për këto pika. Në paragrafin vijues Dhoma e Apelit e kualifikon këtë deklaratë duke u shprehur se “nuk do ta interpretojë Apelin e Prokurorisë si kërkesë për të shfuqizuar fajësinë e Lahi Brahimaajt lidhur me dy nga pikat e lartpërmendura për të cilat ai u dënua, gjegjësisht Pikat 28 dhe 32” dhe se “rrjedhimisht Lahi Brahimaajt nuk do të rigjykohet lidhur me këto dy pika”.⁶⁴ Kjo pasqyrohet në pjesën vendimore të Aktgjykimit të Apelit në të cilën Dhoma e Apelit urdhëroi rigjykimin e Brahimaajt vetëm në lidhje me Pikat 24, 26, 30 dhe 34 dhe jo në lidhje me Pikat 28 dhe 32.⁶⁵ Dhoma Gjyqësore gjykon se prej një leximi të thjeshtë të Aktgjykimi të Apelit del qartë se nuk u urdhërua rigjykimi i Brahimaajt në lidhje me Pikat 28 dhe 32 të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt, të cilat në Aktakuzën e Shkurtuar janë përkatësisht Pikat 3 dhe 5.

⁶⁴ Aktgjykimi i Apelit

⁶⁵ *Po aty*, para. 377.

32. Në lidhje me parashtrimin e Prokurorisë se ajo nuk përpiqet të rigjykojë Brahimajn për Pikën 3 ose për akuzat në Pikën 5 lidhur me krimet kundër Dëshmitarit 3,⁶⁶ Dhoma Gjyqësore konstaton se megjithëse kjo saktësohet në paragrafin 23 të Aktakuzës së Shkurtuar, ajo nuk është shtjelluar më tej në lidhje me Pikën përkatëse ku Brahimaj akuzohet për kryerjen e krimeve të përmendura në çdo Pikë si pjesë e NPK-së.⁶⁷ Duke mbajtur parasysh rëndësinë e aktakuzës si instrumenti akuzues parësor,⁶⁸ Dhoma Gjyqësore konkludon se nuk duhet të ketë paqartësi se për çfarë akuzohen të akuzuarit dhe se pjesët e Aktakuzës së Shkurtuar në lidhje me Pikat 3 dhe 5 nuk pasqyrojnë në masë të mjaftueshme synimet e Prokurorisë në këtë aspekt.

33. Gjithashtu Dhoma Gjyqësore nuk e pranon argumentin e Prokurorisë se Dhoma e Apelit ka urdhëruar që Brahimaj të rigjykohet për atë pjesë të Pikës 5 e cila më parë ishte Pika 32, për të cilën u shpall i pafajshëm në gjykimin e shkallës së parë.⁶⁹ Dhoma Gjyqësore nuk është bindur se kjo nënkuptohet prej paragrafit 51 të Aktgjykimit të Apelit, ku Dhoma e Apelit deklaroi se “nuk do ta interpretojë Apelin e Prokurorisë si kërkesë për të shfuqizuar *fajësinë* e Lahi Brahimajt lidhur me [...] Pikat 28 dhe 32 [dhe] rrjedhimisht Lahi Brahimaj nuk do të rigjykohet lidhur me këto dy pika”.⁷⁰ Deklarimi i Dhomës së Apelit se Brahimaj nuk do të rigjykohet lidhur me këto dy pika, nuk përmban asnjë rezervë që tregon se gjithsesi ai do të rigjykohet për një pjesë të njërës prej dy pikave. për më tepër, përmendja e fajësisë për Pikat 28 dhe 32 duhet kuptuar në termat e

⁶⁶ Përgjigje, para 11.

⁶⁷ Menjëherë pas paragrafit 52 të Aktakuzës së Shkurtuar Prokuroria akuzon:

Me këto veprime dhe mosveprime **Ramush Haradinaj. Idriz Balaj dhe Lahi Brahimaj** kryen si pjesëmarrës në NPK përkufizuar në paragrafët 23 - 25 krimet e mëposhtme;

Pika 3: SHKELJE E LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS, Trajtim Mizor dhe Tortura të njohura në Nenin e Përbashkët 3(1) (a) të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, të ndëshkueshme sipas Nenit 3 dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit.

Menjëherë pas paragrafit 63 të Aktakuzës së Shkurtuar Prokuroria akuzon:

Me këto veprime dhe mosveprime **Ramush Haradinaj. Idriz Balaj dhe Lahi Brahimaj** kryen si pjesëmarrës në NPK përkufizuar në paragrafët 23 - 25 krimet e mëposhtme;

Pika 5: SHKELJE E LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS, Vrasje, Trajtim Mizor dhe Tortura të njohura në Nenin e Përbashkët 3(1) (a) të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, të ndëshkueshme sipas Nenit 3 dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit.

⁶⁸ Prokurori kundër Kupreshkiqit, Kupreshkiqit, Kupreshkiqit, Josipoviqit dhe Shantiqit, Lënda Nr. IT-95-16-A, Aktgjykim, 23 tetor 2001 (“Aktgjykimi i Apelit Kupreshkiq dhe të tjerë”), para. 114.

⁶⁹ Përgjigje, para.14.

⁷⁰ Po aty., para. 14.

Vendimit të Aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore ku Brahimaj u shpall fajtor për dy pika, sërish pa asnjë rezervë.⁷¹

34. Përmbledhtazi, meqë Dhoma e Apelit nuk ka urdhëruar rigjykimin e Brahimajt për Pikat 3 dhe 5, pjesët në Aktakuzë lidhur me këto Pika duhen ndryshuar në mënyrë të tillë që të mos figurojë pretendimi se ai ka kryer krime në lidhje me këto Pika në kuadrin e NPK-së.

35. Lahi Brahimaj argumenton se rigjykimi për Pikat 3 dhe 5 shkel parimin *ne bis in idem*⁷² dhe Prokuroria e kundërshton këtë argument.⁷³ Dhoma Gjyqësore e gjykon të panevojshme të shtjellojë zbatimin e parimit *ne bis in idem* në lidhje me rigjykimin e pjesshëm të Brahimajt për Pikat 3 dhe 5 të duke qenë se doli qartë se Dhoma e Apelit nuk urdhëroi rigjykimin e tij për këto Pika.

D. Pretendimet për Mangësi në formën e Aktakuzës së Shkurtuar

36. Parashtrimi i Brahimajt se Aktakuza e Shkurtuar përmban data materiale kundërthënëse në paragrafët 30(b) dhe 41⁷⁴ përbën akuzë për mangësi në formën e aktakuzës. Gjithashtu ai parashtron se Aktakuza e Shkurtuar ka mangësi në shtjellimin e elementit mendor të NPK-së.⁷⁵

37. Si datat materiale kundërthënëse, po ashtu edhe pretendimi për mangësi në shtjellimin e elementit në NPK, ishin në Aktakuzën e Ndryshuar për Herë të Katërt. Bazuar në Rregullën 72(A)(ii) mocionet paraprake që pretendojnë mangësi në formën e aktakuzës, paraqiten jo më vonë se tridhjetë ditë pasi Prokuroria i ka bërë të njohur mbrojtjes të gjithë materialin dhe deklaratat e përmendura në Rregullën 66(A)(i). Në Konferencën për Gjendjen, më 23 shtator 2010, Gjykatësi Paragjyqësor deklaroi se publikimi i materialit sipas Rregullës 66(A)(i) kishte përfunduar.⁷⁶ Rrjedhimisht argumentet e Brahimajt që lidhen me mangësi në Aktakuzën e Shkurtuar janë bërë pas

⁷¹ Aktgjykim, para 504.

⁷² Parashtrim i Brahimajt, para 2.b. *Shih edhe* para 14-39.

⁷³ Përgjigje, para. 13.

⁷⁴ Parashtrim i Brahimajt, para 2.c., 40-42.

⁷⁵ *Po aty.*, para 56-58.

⁷⁶ T. 21 (23 shtator 2010).

mbarimit të afatit të përcaktuar në Rregullën 72(A)(ii). Gjithsesi Dhoma Gjyqësore gjykon se nuk është në interes të drejtësisë që parashtrimet e Brahimajt të hidhen poshtë për këtë arsye.

38. Paragrafi 4 i Nenit 18 të Statutit dhe paragrafi C i Rregullës 47 përcaktojnë se aktakuza përmban një përshkrim të shkurtër dhe të saktë të fakteve të çështjes dhe të krimeve për të cilat akuzohet i akuzuari. Dhoma e Apelit ka konkluduar se çështja nëse aktakuza është shtjelluar në hollësi të mjaftueshme varet se a janë parashtruar në hollësi të mjaftueshme faktet materiale të argumentit të Prokurorisë në mënyrë që i akuzuari të informohet qartësisht për akuzat kundër tij me qëllim që ai të mund të përgatisë mbrojtjen e tij.⁷⁷ Gjithashtu u konkludua se aspekti nëse një fakt konkret është material, varet prej natyrës së argumentimit të Prokurorisë dhe faktor përcaktues për masën e konkretësisë që i kërkohet Prokurorisë për paraqitjen e fakteve të çështjes në aktakuzë është natyra e veprimeve kriminale për të cilat akuzohet i akuzuari.⁷⁸

39. Paragrafët 30(b) dhe 41 të Aktakuzës së Shkurtuar janë mospërputhës në lidhje me datën e fillimit të funksionimit të objektit të burgimit të UÇK-së në Jabllanicë: në paragrafin 30(b) pretendohet se Brahimaj ka drejtuar objektin e burgimit së paku prej prillit 1998 dhe në paragrafin 41 pretendohet se objekti i burgimit është ngritur në mes të majit 1998. Data është materiale sepse në paragrafin 30(b) pretendohet se Brahimaj mori pjesë në NPK, nëpërmjet drejtimit të objektit të burgimit me qëllim burgosjen dhe keqtrajtimin e civilëve. Prokuroria parashtron se Dosja Paragjyqësore e Prokurorisë ofron më shumë hollësi në paragrafin 50⁷⁹ ku shkruhet se objekti i burgimit “ishte në funksionim” së paku prej prillit 1998. Mirëpo Dhoma Gjyqësore nuk mendon se kjo e ndreq mangësinë. Në paragrafin 50 të Dosjes Paragjyqësore të Prokurorisë sugjerohet se paragrafi 41 ka nevojë për korrigjim, mirëpo korrigjimi konkret i nevojshëm nuk del qartë prej paragrafit 50. Megjithëse është konkluduar se dosja paragjyqësore mund të

⁷⁷ Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerë*, para.88.

⁷⁸ Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerë*, para.89.

⁷⁹ Përgjigje, para 17.

zgjidhë paqartësitë në aktakuzë,⁸⁰ mospërputhje si ato midis paragrafëve 30(b0 dhe 41 mund të ndreqen si duhet vetëm nëpërmjet korrigjimit të vetë aktakuzës.

40. Brahimaj pretendon se shtjellimi i elementit material të NPK-së në paragrafin 23 të Aktakuzës së Shkurtuar nuk është qartësues në masën e duhur⁸¹ dhe “nuk është më e mundshme për mbrojtjen të dijë çfarë forme e NPK-së pretendohet”.⁸² Në paragrafin 23 Prokuroria pretendon se “çdo i Akuzuari kishte të njëjtin synim me bashkëfajtorët e tjerë për të kryer krimet brenda qëllimit kriminal të përbashkët të NPK-së dhe se “ndryshe, në qoftë se disa krime nuk ishin pjesë e NPK-së, ato ishin pasoja të natyrshme dhe të parashikueshme të NPK-së dhe secili i Akuzuari ishte i vetëdijshëm se këto krime ishin pasoja të natyrshme dhe të parashikueshme të zbatimit të NPK-së.” Kështu parashtrohet qartë elementi mendor dhe kuadri i tij për secilën prej dy alternativave dhe Dhoma Gjyqësore nuk gjykon se në këtë pikë Aktakuza e Shkurtuar ka mangësi.

E. Pranueshmëria e Provave

41. Haradinaj parashtron se bazuar në urdhrin e Dhomës së Apelit çfarëdo prove që nuk ka lidhje me Jabllanicën duhet përjashtuar⁸³; dhe Balaj parashtron se Prokuroria nuk mund të paraqesë në rigjykimin e pjesshëm prova në lidhje me akuza mbi fakte për të cilat ai u shpall i pafajshëm drejtpërsëdrejti ose tërthorazi në gjykimin e shkallës së parë.⁸⁴ Dhoma Gjyqësore pajtohet me Prokurorinë se këto parashtrime janë të nxituara.⁸⁵ Ato dalin jashtë kuadrit të objektivit të Urdhrit të 3 nëntorit dhe nuk kanë lidhje me brendinë e Aktakuzës së Shkurtuar. Për më tepër, Dhoma Gjyqësore thekson se Dhoma e Apelit urdhëroi rigjykim të pjesshëm dhe jo thjesht kthim të vendimeve të Dhomës Gjyqësore që u shfuqizuan në lidhje me dëshmitë për t’u dëgjuar prej Shefqet Kabashit dhe dëshmitarit tjetër. Gjithashtu Dhoma Gjyqësore thekson se urdhri për rigjykim të

⁸⁰ *Mikaëili Muhinana k. Prokurorit*, Lënda Nr. ICTR-95-1B-A, Aktgjykim, 21 maj 2007, para 82, 201, 223; *Prokurori k. Elizaphan Ntakirutimana-s dhe Gérard Ntakirutimana-s*, Lëndët Nr. ICTR-96-10-A dhe ICTR-96-17-A Aktgjykim, 13 dhjetor 2004, para 48. *Shih edhe Prokurori kundër Mlladen Naletiliqit dhe Vinko Martinoviqit*, Lënda Nr. IT-98-34-A, Aktgjykim, 3 maj 2006, para 45.

⁸¹ Parashtrim i Brahimajt, para. 56.

⁸² *Po aty.*, para. 57.

⁸³ Parashtrim i Haradinajt, para 3, 21.

⁸⁴ Parashtrim i Balajt, para 29.

⁸⁵ Përgjigje, para 18-19.

pjesshëm nuk përcakton kufij për provat që mund të paraqesë Prokuroria për vërtetimin e akuzave të aktakuzës në Pikat për të cilat u urdhërua rigjykimi.

IV. VENDIM

42. Për këto arsye, bazuar në Nenin 18(4) të Statutit dhe Rregullat 47(C), 54, 72(A) dhe 126bis, Dhoma Gjyqësore

- (1) **I LEJON** Balajn dhe Brahimajn të paraqesin kundërpërgjigje
- (2) **URDHËRON** që Prokuroria të korrigjojë Aktakuzën e Shkurtuar si më poshtë;
 - (a) Paragrafi 23 të korrigjohet në mënyrë të tillë që të mos figurojë akuzë se Lahi Brahimaj ishte penalisht përgjegjës për çfarëdo krimi të Pikës 5;
 - (b) Paragrafi 24 të zëvendësohet prej paragrafit 26 të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt;
 - (c) Të hiqet mospërputhja midis datave të dhëna në paragrafët 30(b) dhe 41;
 - (d) Fjalja menjëherë pas paragrafit 52 të ndryshojë në mënyrë që të mos figurojë akuza se Lahi Brahimaj kreu krimet e Pikës 3; dhe
 - (e) Fjalja menjëherë pas paragrafit 63 të ndryshojë në mënyrë që të mos figurojë akuzë se Lahi Brahimaj kreu krimet e Pikës 5.
- (3) **URDHËRON** që brenda 21 janarit 2011 Prokuroria të paraqesë Aktakuzën e Shkurtuar të rishikuar në një version “të pastër” dhe në një version në të cilin korrigjimet në Aktakuzën e Ndryshuar për Herë të Katërt të jenë shënuar me opsionin “tracking”; dhe
- (4) **HEDH POSHTË** Mocionin e Mbrojtjes në të tëra aspektet e tjera.

Përkthim

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

/nënshkruar në origjinal/

Gjykatës Bakone Justice Moloto
Kryegjykatës

Sot, më datën 14 janar 2011.

Në Hagë

Holandë

[Vula e Tribunalit Ndërkombëtar]